

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Ruse në Bullgari, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023 në Universitetin Ruse në Bullgari.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e Universitetit Metropolitan Tirana në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT të ciklit:

- Bachelor

(Programet: Administrim Biznes dhe Inxhinieri Kompjuterike)

- Master

(Programet: MBA dhe Inxhinieri Informatike)

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Forma e aplikimit ([klikoni këtu](#))
- Learning Agreement
- Transkripti i notave
- Kopje e pasaportës
- Deklaratë për pjesëmarrjen e mëparshme ne Erasmus+ ([klikoni këtu](#))

Afati për aplikim: 25 Nëntor, 2022



Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

Për më shumë informacion mbi bursat dhe dokumentet që duhen plotësuar mund të na kontaktoni në adresën: edoku@umt.edu.al

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!